



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

**Ministria e Drejtësisë –Ministarstvo Pravde –Ministry of Justice**

---

**UDHËZIM ADMINISTRATIV MD-NR. 14/2023<sup>1</sup>**  
**PËR FUNKSIONIMIN E NJËSISË EKONOMIKE**

---

<sup>1</sup> Udhëzim Administrativ MD-Nr. 14/2023 për funksionimin e njësisë ekonomike, i nënshkruar nga Ministria e Drejtësisë më datë 14.11.2023

## **Ministrja e Ministrisë së Drejtësisë,**

Në mbështetje të nenit 16, paragrafi 8 të Ligjit Nr. 08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës, duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe në Shtojcën 1 (pika 3) të Rregullores (QRK) - Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe në përputhje me nenin 38 (paragrafit 6) të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011 së Republikës së Kosovës,

Nxjerrë:

### **UDHËZIM ADMINISTRATIV MD-NR. 14/2023 PËR FUNKSIONIMIN E NJËSISË EKONOMIKE**

#### **KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

##### **Neni 1 Qëllimi**

Me këtë Udhëzim Administrativ përcaktohet funksionimi i Njesisë Ekonomike përmes zhvillimit të aktiviteteve ekonomike, krijimit të të hyrave, mundësimit të punësimit të burgosurve me qëllim të risocializimit dhe ri integrimit të tyre në shoqëri.

##### **Neni 2 Fushëveprimi**

Ky Udhëzim Administrativ zbatohet nga të gjitha institucionet korrektuese në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: SHKK), institucionet publike dhe operatorë të ndryshëm ekonomik në pajtim me legjislacionin në fuqi.

##### **Neni 3 Përkufizimet**

1. Për qëllimet e këtij Udhëzimi Administrativ, shprehjet e mëposhtme do ta kenë këtë kuptim:

1.1. **Impianti** - punëtoritë për punësimin e të burgosurve;

1.2. **Aktivitet ekonomik** - nënkupton çdo aktivitet në të cilin prodhohen, shiten produkte si dhe ofrohen shërbime nga të punësuarit e njesisë ekonomike;

1.3. **Punësimi** - angazhimi i të burgosurve në punë brenda Institucionit Korrektues.

## **KAPITULLI II FUNKSIONIMI I NJËSISË EKONOMIKE**

### **Neni 4 Funksionet e Njesisë Ekonomike**

1. Njësia Ekonomike zhvillon aktivitete ekonomike, prodhuese, ofron shërbime, punëson të burgosurit bazuar në planin individual të dënimit me qëllim të risocializimit dhe ri integritimit, krijon të hyra për nevojat e të burgosurve dhe SHKK-së.
2. Njësia Ekonomike prodhon dhe përpunon produkte bujqësore dhe industriale nga punëtoritë e saj për nevojat e SHKK-së, produktet të cilat konsiderohen tepriçë i plasojnë në treg.
3. Njësia Ekonomike në bazë të kapacitetit të saj mund të prodhojë dhe përpunojë produkte industriale dhe t'i plasojnë në treg.
4. Në bazë të aktivitetit ekonomik Njësia krijon të hyra dhe këto të hyra i shfrytëzon për nevoja të Shërbimit Korrektues të Kosovës.
5. Të hyrat e realizuara nga aktiviteti ekonomik do të shpenzohen në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.
6. Njësia Ekonomike menaxhon me blerjet dhe shitjet, përgatitë analiza për të hyrat nga institucionet përkatëse duke pasur për bazë kultivimin e kulturave të ndryshme bujqësore si dhe veprimtarive prodhuese dhe shërbyese.
7. Ministri i Drejtësisë me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm mund të lidhë marrëveshje me operatorë të ndryshëm lidhur me aktivitetet ekonomike sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

### **Neni 5 Aktiviteti ekonomik**

1. Njësia Ekonomike zhvillon aktivitete përmes impianteve si në vijim:
  - 1.1. Agrokultura me nëndegët e saj:
    - 1.1.1. Blegtoria me nëndegët e saj;
    - 1.1.2. Pemëtaria;
    - 1.1.3. Perimtaria;
    - 1.1.4. Lavërtaria dhe kultivimi i kulturave bujqësore.
  - 1.2. Prodhimi dhe përpunimi i produkteve nga:

1.2.1. Metali;

1.2.2. Druri;

1.2.3. Plastika;

1.2.4. Tekstili;

1.2.5. Letra;

1.2.6. Artizanate, veprimtari artistike, dizajn dhe printim grafik.

1.3. Prodhimi dhe përpunimi i produkteve të brumërave;

2. Aktivitete tjera sipas nevojës.

## **Neni 6 Shërbimet e ofruara**

1. Njësia Ekonomike varësisht nga nevojat e Institucionit Korrektues ofron shërbime si në vijim:

1.1. mirëmbajtja dhe renovimi i objekteve në Institucion Korrektues;

1.2. mirëmbajtja e pajisjeve elektroteknike;

1.3. Mirëmbajtja, servisimi i mjeteve motorike dhe pajisjeve bujqësore.

## **Neni 7 Punësimi i të burgosurve**

1. Njësia Ekonomike realizon dhe ndërmjetëson punësimet e të burgosurve në punët brenda dhe jashtë Institucioneve Korrektuese siç përcaktohet me legjislacionin përkatës në fuqi.

2. Procesi i punësimit të burgosurve realizohet përmes njësisë ekonomike në bazë të nevojave të Institucionit Korrektues në bashkëpunim me zyrtarin përgjegjës për punë.

3. Njësia Ekonomike përcakton numrin e të burgosurve të cilët do të angazhohen në punë dhe kërkon përmes zyrtarit përgjegjës për punë në Institucionin Korrektues identifikimin e të burgosurve në profilet përkatëse.

4. Procesi i punësimit të burgosurve që angazhohen në punë, realizohet përmes Njësisë Ekonomike, e cila kërkon nga Institucioni Korrektues përmes zyrtarit përgjegjës për numrin e të burgosurve dhe profilet të cilët duhet të angazhohen në punë.

5. Procesi i punësimit të burgosurve në punë që nuk janë pjesë e aktiviteteve të njësisë ekonomike bëhet nga vetë Institucioni Korrektues.

6. Njësia Ekonomike mban regjistër për të gjithë të burgosurit e punësuar.

## **Neni 8**

### **Plani zhvillimor i Njesisë Ekonomike**

1. Njësia Ekonomike në bashkëpunim me zyrtarët përgjegjës në Institucione Korrektuese e harton planin vjetor të aktiviteteve ekonomike.
2. Plani vjetor nga paragrafi 1 i këtij neni miratohet nga Drejtori i Përgjithshëm i SHKK-së.
3. Njësia Ekonomike është përgjegjëse për zbatimin e planit vjetor të aktiviteteve ekonomike.

## **Neni 9**

### **Prodhimi dhe përpunimi i produkteve**

1. Njësia Ekonomike menaxhon me procesin e prodhimit dhe përpunimin e produkteve të prodhuara nga kjo njësi.
2. Njësia Ekonomike mbanë regjistër për produktet e prodhuara, menaxhon me stoqet dhe bënë shpërndarjen e tyre në Institucionet Korrektuese.
3. Për furnizim me produkte për nevoja të Institucionit Korrektues, kërkesa i parashtrohet Njesisë Ekonomike.

## **Neni 10**

### **Shitja e produkteve**

SHKK përmes Njesisë Ekonomike i shetë produktet e përpunuara apo prodhuara në impiantet e Institucioneve Korrektuese.

## **Neni 11**

### **Çmimi i produkteve**

1. Çmimi i produkteve të prodhuara apo përpunuara në impiantet e Njesisë Ekonomike përcaktohet nga komisioni i themeluar nga Drejtori i Përgjithshëm i SHKK-së.
2. Përcaktimi i çmimit të produkteve nga paragrafi 1 i këtij neni bazohet në çmimin e tregut me shumicë.
3. Përfundimisht paragrafit 2 të këtij neni, për produktet e veçanta, për të cilat nuk mund të sigurohet çmimi i tregut me shumicë, çmimi përcaktohet duke u bazuar në koston e përgjithshme të prodhimit, përpunimit apo shërbimit.
4. Komisioni e dorëzon raportin për caktimin e çmimit të produktit tek Drejtori i Përgjithshëm i SHKK-së dhe Udhëheqësi i Njesisë Ekonomike.
5. Njësia Ekonomike pas pranimit të raportit për caktimin e çmimit, produktet të cilat konsiderohen tepriçë i plason në treg në pajtim me procedurat përkatëse të prokurimit apo përmes formave të tjera në pajtim me legjislacionin në fuqi.

**Neni 12**  
**Donacionet e produkteve**

1. Përveç shitjes së produkteve, SHKK produktet mund t'i dhuroj donacion institucioneve publike dhe organizatave tjera që ofrojnë përkuajdesje sociale.
2. Përjashtimisht, produkteve të tjera, vlera e përgjithshme e donacioneve të produkteve industriale nuk mund të jetë me shumë se 10% e qarkullimit të vitit paraprak.
3. Vendimin për donacionin e dhuruar e nënshkruan Drejtori i Përgjithshëm.

**Neni 13**  
**Të hyrat nga shitja e produkteve**

1. Për inkasimin e të hyrave nga shitja e produkteve, Ministria e Drejtësisë - SHKK do të kërkoj nga Thesari të hapë llogari bankare në Banka Qendrore e Kosovës (BQK).
2. Të gjitha të hyrat e inkasura nga shitja e produkteve duhet të transferohen në llogarinë përkatëse të hapur në BQK, regjistrohen në SIMFK (Sistemi informativ i Menaxhimit të Financave të Kosovës) dhe alokohen në harmoni me Ligjin për Ndarjet Vjetore të buxhetit.

**Neni 14**  
**Ofrimi i shërbimeve për organizatat tjera buxhetore**

1. Njësia Ekonomike mund të ofroj shërbime për organizata tjera buxhetore.
2. Ofrimi i shërbimeve bëhet sipas marrveshjes së lidhur në mes të Drejtorit Përgjithshëm të SHKK-së dhe përfaqesuesit të organizatës tjetër buxhetore.
3. Njësia Ekonomike menaxhon me procedurat e ofrimit të shërbimeve.

**Neni 15**  
**Impiantet**

Me qëllim që të burgosurvë t'iu mundësohet të punojnë, brenda institucioneve korrektuese mund të jepet leja për ndërtimin e impianteve në pajtim me legjislacionin në fuqi.

**Neni 16**  
**Buxheti i Njësisë Ekonomike**

1. Buxheti i Njësisë Ekonomike planifikohet në kuadër të SHKK-së, përkatësisht Ministrisë së Drejtësisë dhe miratohet sipas Ligjit mbi Ndarjet Buxhetore çdo vit fiskal dhe atë përmes këtyre burimeve të financimit:

- 1.1. Granti Qeveritar;

1.2. Të hyrat vetanake, nëse me Ligjin për Ndarje Buxhetore SHKK-së i lejohet shfrytëzimi i të hyrave;

1.3. Donacioneve.

**Neni 17**  
**Hyrja në fuqi**

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetë Zyrtare.

**Albulena Haxhiu**

---

**Ministre e Drejtësisë**

14/11/2023